<p>ose me ndihmën e teknologjive të tjera të ngjashme, përveç atyre të botimit; dhe riprodhimit në një formë elektronike ose në çdo formë tjetër të lexueshme nga makina;</p> <p>1.33 “Injektim i drejtpërdrejtë” – nënkupton një proces teknik me anë të të cilit një organizatë transmetuese transmeton sinjalet e saj bartëse të programit, tek një organizatë tjetër, në mënyrë të tillë që sinjalet bartëse të programit të mos jenë të qasshme për publikun gjatë atij transmetimi;</p> <p>1.34. “Shërbim ndihmës në internet” - nënkupton një shërbim në internet që konsiston në ofrimin për publikun, nga ose nën kontrollin dhe përgjegjësinë e një organizate transmetuese, të radio ose programeve televizive njëkohësisht me ose për një periudhë të caktuar kohore pas transmetimit të tyre nga organizata transmetuese; si dhe çdo material që është ndihmës për një transmetim të tillë;</p> <p>1.35. “Organizatë hulumtuese” – nënkupton një universitet, përfshirë bibliotekat e tij, një institut hulumtimi ose çdo subjekt tjetër, qëllimi kryesor i të cilit është të kryejë hulumtime</p>	<p>with the aid of other similar technologies, except those of (i) publishing; and (ii) reproduction in an electronic or in any other machine-readable form;</p> <p>1.33. “Direct injection” - a technical process by which a broadcasting organisation transmits its programme-carrying signals to an organisation other than a broadcasting organisation, in such a way that the programme-carrying signals are not accessible to the public during that transmission;</p> <p>1.34. “Ancillary online service” - an online service consisting in the provision to the public, by or under the control and responsibility of a broadcasting organisation, of television or radio programmes simultaneously with or for a defined period of time after their broadcast by the broadcasting organisation, as well as of any material which is ancillary to such broadcast;</p> <p>1.35. “Research organisation”- a university, including its libraries, a research institute or any other entity, the primary goal of which is to conduct scientific research or to carry</p>	<p>drugih sličnih tehnologija, osim izdavačkih; i reprodukciju u elektronskom ili bilo kom drugom mašinski čitljivom obliku;</p> <p>1.33 “Direktno ubrizgavanje” – podrazumeva tehnički proces kojim radiodifuzna organizacija prenosi svoje signale nosioca programa drugoj organizaciji na način da signali nosioca programa nisu dostupni javnosti tokom tog emitovanja;</p> <p>1.34. “Pomoćna usluga na internetu” - podrazumeva internet uslugu koji se sastoji u pružanju publici, od strane ili pod kontrolom i odgovornošću radiodifuzne organizacije, radio ili televizijskih programa istovremeno sa ili u određenom vremenskom periodu nakon njihovog emitovanja od strane radiodifuzne organizacije; kao i svaki materijal koji je sporedan takvom emitovanju;</p> <p>1.35. Istraživačka organizacija – univerzitet, uključujući njegove biblioteke, istraživački institut ili bilo koji drugi subjekat, čiji je primarni cilj sprovođenje naučnog istraživanja ili</p>
--	---	--

<p>shkencore ose të kryejë aktivitete edukative që përfshijnë edhe kryerjen e kërkimit shkencor:</p> <p>1.35.1. në baza jofitimprurëse ose duke riinvestuar të gjitha fitimet në kërkimin e saj shkencor; ose</p> <p>1.35.2. në zbatim të një misioni me interes publik të njohur nga shteti.</p> <p>1.36. “Vepra jetime” –nënkupton një vepër ose një fonogram, në rast se asnjëri nga mbajtësit e të drejtave në atë vepër apo fonogram nuk është i identifikuar, apo edhe nëse një ose më shumë prej tyre janë të identifikuar, por asnjëri prej tyre nuk gjendet pavarësisht se është bërë kërkim i plotë dhe i arsyeshëm për mbajtësit e të drejtave dhe është regjistruar në përputhje me këtë ligj:</p> <p>1.36.1. Veprat e botuara në formën e librave, revistave profesionale, gazetave, revistave ose shkrimeve të tjera;</p> <p>1.36.2. Veprat kinematografike ose audiovizuale dhe fonogramet;</p>	<p>out educational activities involving also the conduct of scientific research:</p> <p>1.35.1 on a not-for-profit basis or by reinvesting all the profits in its scientific research; or</p> <p>1.35.2 pursuant to a public interest mission recognized by the State.</p> <p>1.36. “Orphan work” - means a work or a phonogram, in case none of the holders of the rights in that work or phonogram are identified, or even if one or more of them are identified, but none of them can be found notwithstanding that full and reasonable search has been made for the rights holders and registered in accordance with this law.</p> <p>1.36.1. Works published in the form of books, journals, newspapers, magazines or other writings;</p> <p>1.36.2. Cinematographic or audiovisual works and phonograms;</p>	<p>obavljane obrazovnih aktivnosti koje uključuju i sprovođenje naučnog istraživanja:</p> <p>1.35.1. na neprofitnoj osnovi ili ponovnom investiranju celokupne dobiti u svoja naučna istraživanja; ili</p> <p>1.35.2. u sprovođenju misije od javnog interesa priznatu od države.</p> <p>1.36. “Dela siročadi” –podrazumeva delo ili fonogram, u slučaju da niko od nosilaca prava na tom delu ili fonogramu nije identifikovan, ili čak i ako se identifikuje jedan ili više njih, ali nijedan od njih nije pronađen iako je pretraga obavljena potpuna i razumna nosiocima prava i registrovan je u skladu sa ovim zakonom:</p> <p>1.36.1. Dela izdavana u obliku knjiga, stručnih časopisa, novina, časopisa ili drugih spisa;</p> <p>1.36.2. Kinematografska ili audiovizuelna dela i fonogrami;</p>
---	---	---

<p>1.36.3. Veprat kinematografike ose audiovizuale dhe fonogramet e prodhuara nga organizatat transmetuese publike deri më 31 dhjetor 2002 dhe përfshirë në arkivat e tyre, të cilat mbrohen nga e drejta e autorit ose të drejtat e përafërta dhe që janë botuar për herë të parë në Republikën e Kosovës ose në mungesë të publikimit, janë transmetuar për herë të parë në Republikën e Kosovës;</p> <p>1.36.4. Veprat dhe lëndët e tjera të mbrojtura që janë të përfshira ose të integruara në, ose përbëjnë pjesë bazike të veprave ose fonogrameve të sipërpërmendura. Nëse këto vepra nuk botohen ose transmetohen, ato mund të përdoren nga përfituesit e veprave jetime vetëm nëse: janë bërë qasshme për publikun nga cilido prej përfituesve të veprave jetime (qoftë edhe në formën e një huadhënieje) me pëlqimin e bartësve të së drejtave dhe është e arsyeshme të supozohet se mbajtësit e të drejtave nuk do të kundërshtonin përdorimet e lejuara të përmendura në nenin</p>	<p>1.36.3. Cinematographic or audiovisual works and phonograms produced by public-service broadcasting organisations up to and including 31 December 2002 and contained in their archives, which are protected by copyright or related rights and which are first published in the Republic of Kosovo or, in the absence of publication, first broadcast in the Republic of Kosovo;</p> <p>1.36.4. works and other protected subject-matter that are embedded or incorporated in, or constitute an integral part of, the above mentioned works or phonograms. If these works are not published or broadcast, they can be used by the beneficiaries of orphan works only if: i) they have been made publicly accessible by anyone of the beneficiaries of orphan works (even in the form of a lending) with the consent of the rightholders, and ii) it is reasonable to assume that the rightholders would not oppose the permitted uses referred to</p>	<p>1.36.3. Kinematografska ili audiovizuelna dela i fonograme koje su proizvele javne radiodifuzne organizacije do 31. decembra 2002. godine i uključene u njihove arhive, koje su zaštićene autorskim ili srodnim pravima i koje su prvi put objavljene u Republici Kosovo ili u nedostatku objavljivanja, su prvi put emitovani u Republici Kosovo;</p> <p>1.36.4. Dela i drugi zaštićeni predmeti koji su uključeni ili integrisani u, ili čine osnovni deo navedenih dela ili fonograma. Ako se ova dela ne objavljuju ili emituju, korisnici dela siročadi mogu da ih koriste samo ako: ih učini dostupnim javnosti bilo ko od korisnika dela siročadi (čak i u obliku pozajmice) uz saglasnost nosilaca prava i razumno je pretpostaviti da se nosioci prava neće protiviti dozvoljenoj upotrebi iz člana 51. Ovaj stav se primenjuje na dela i fonograme koji su deponovani u tim organizacijama pre 29. oktobra 2014. godine. u zbirka</p>
---	--	--

<p>51. Ky paragraf do të zbatohet për veprat dhe fonogramet që janë depozituar në ato organizata përpara datës 29 Tetor 2014. të përfshira në koleksionet (zotërimet) e bibliotekave, institucioneve arsimore, muzeve, arkivave dhe institucioneve në fushën e trashëgimisë kinematografike dhe audio qasshme nga publiku, nëse zotërimet janë botuar tashmë, titullari i të cilave nuk mund të bëhet i njohur ose gjurmohet pavarësisht nga një kërkim i plotë.</p> <p>1.37. “Nxjerrja e tekstit dhe e të dhënave”- çdo teknikë analitike e automatizuar që synon analizimin e tekstit dhe të dhënave në formë dixhitale me qëllim të gjenerimit të informacionit që përfshin, por nuk kufizohet në modele, trende dhe korrelacione;</p> <p>1.38. “Institucion i trashëgimisë kulturore” – nënkupton një bibliotekë ose muze të qasshëm nga publiku, një arkiv ose një institucion i trashëgimisë audio ose filmike;</p>	<p>in article 51. This paragraph shall apply to works and phonograms which have been deposited with those organisations before 29 October 2014.contained in in the collections (holdings) of publicly accessible libraries, educational institutions, museums, archives and institutions in the field of cinematic and audio heritage, if the holdings have already been published, the rightholder of which could not be established or traced despite a diligent search.</p> <p>1.37. “Text and data mining”- any automated analytical technique aimed at analysing text and data in digital form in order to generate information which includes but is not limited to patterns, trends and correlations;</p> <p>1.38. “Cultural heritage institution” - a publicly accessible library or museum, an archive or a film or audio heritage institution;</p>	<p>(posedima) biblioteka, obrazovnih ustanova, muzeja, arhiva i ustanova iz oblasti kinematografskog i audio-nasleđa dostupnih javnosti, ako je fond već objavljen, čiji se vlasnik ne može saznati niti ući u trag uprkos detaljnom istraživanju.</p> <p>1.37. “Ekstrakcija teksta i podataka”- svaka automatizovana analitička tehnika koja ima za cilj analizu teksta i podataka u digitalnom obliku u svrhu generisanja informacija uključujući, ali ne ograničavajući se na obrasce, trendove i korelacije;</p> <p>1.38. “Institucija kulturnog nasleđa” –javno biblioteku ili muzej, dostupne od publike, arhivu ili instituciju audio ili filmskog nasleđa;</p>
---	--	--

<p>1.39. “Botim i shtypit”- nënkupton një përmbledhje e përbërë kryesisht nga vepra letrare me karakter publicistik, por që mund të përfshijë edhe vepra të tjera ose lëndë të tjera dhe që:</p> <p>1.39.1. përbën një artikull individual brenda një botimi periodik ose të përditësuar rregullisht nën një titull të vetëm, si një gazetë ose një revistë me interes të përgjithshëm ose të veçantë;</p> <p>1.39.2. ka për qëllim t'i sigurojë publikut të gjerë informacion në lidhje me lajme ose tema të tjera;</p> <p>1.39.3. botohet në cilëndo media nën iniciativën, përgjegjësinë editoriale dhe kontrollin e një ofruesi të shërbimit.</p> <p>Revistat periodike që botohen për qëllime shkencore ose akademike, siç janë revistat shkencore, nuk janë botime shtypi për qëllimet e këtij Ligji.</p> <p>1.40. “Shërbimi i shoqërisë së informacionit”- nënkupton çdo shërbim të shoqërisë së informacionit, çdo shërbim i ofruar me shpërblim, në një</p>	<p>1.39. “Press publication”-a collection composed mainly of literary works of a journalistic nature, but which can also include other works or other subject matter, and which:</p> <p>1.39.1. constitutes an individual item within a periodical or regularly updated publication under a single title, such as a newspaper or a general or special interest magazine;</p> <p>1.39.2. has the purpose of providing the general public with information related to news or other topics;</p> <p>1.39.3. is published in any media under the initiative, editorial responsibility and control of a service provider. Periodicals that are published for scientific or academic purposes, such as scientific journals, are not press publications for the purposes of this Law.</p> <p>1.40. “Information society service” or “online service provider”- any natural or legal person providing an information society service which</p>	<p>1.39. “Izdanje štampe”- podrazumeva zbirku koja se sastoji uglavnom od književnih dela novinarske prirode, ali koja može uključivati i druga dela ili druge teme i koja:</p> <p>1.39.1. čini pojedinačni članak u okviru periodičnog ili redovnog ažuriranog izdanja pod jednim naslovom, kao što su novine ili časopisi opšteg ili posebnog interesa;</p> <p>1.39.2. ima za cilj da široj javnosti pruži informacije o novostima ili drugim temama;</p> <p>1.39.3. izdaje se u bilo kom mediju pod inicijativom, uređivačkom odgovornošću i kontrolom pružaoca usluga. Periodična izdanja objavljene u naučne ili akademske svrhe, kao što su naučni časopisi, nisu publikacije za štampu u smislu ovog zakona.</p> <p>1.40. “Usluga informacionog društva”- podrazumeva bilo koju uslugu informacionog društva, bilo koju uslugu koja se nudi uz naknadu, na</p>
--	--	---

<p>distancë, me mjete elektronike dhe me kërkesë individuale të marrësit të shërbimeve;</p> <p>1.41. “Ofrues i shërbimit të shpërndarjes së përmbajtjes në internet”- nënkupton një ofrues i një shërbimi të shoqërisë së informacionit, qëllimi kryesor ose një nga qëllimet kryesore të të cilit është ruajtja dhe dhënia e qasjes publikut në një sasi të madhe veprash të mbrojtura nga e drejta e autorit ose lëndë të tjera të mbrojtura të ngarkuara nga përdoruesit e saj, të cilët i organizon dhe i promovon për qëllime fitimi. Ofruesit e shërbimeve, të tilla si enciklopeditë jofitimprurëse në internet, depot arsimore dhe shkencore jofitimprurëse, platformat e zhvillimit dhe shpërndarjes së softuerit me kod të hapur, ofruesit e shërbimeve të komunikimit elektronik, tregjet në internet, shërbimet në re/cloud nga biznesi në biznes dhe shërbimet në re/cloud që u mundësojnë përdoruesve të ngarkojnë përmbajtje për përdorimin e tyre personal, nuk janë “ofrues shërbimesh për shpërndarjen e përmbajtjes në internet” sipas kuptimit të këtij Ligji;</p>	<p>means any service normally provided for remuneration, at a distance, by electronic means and at the individual request of a recipient of services;</p> <p>1.41. “Online content-sharing service provider”-a provider of an information society service of which the main or one of the main purposes is to store and give the public access to a large amount of copyright-protected works or other protected subject matter uploaded by its users, which it organises and promotes for profit-making purposes. Providers of services, such as not-for-profit online encyclopedias, not-for-profit educational and scientific repositories, open source software-developing and-sharing platforms, providers of electronic communications services, online marketplaces, business-to-business cloud services and cloud services that allow users to upload content for their own use, are not “online content-sharing service providers” within the meaning of this Law;</p>	<p>daljinu, elektronskim putem i na individualni zahtev primaoca usluga;</p> <p>1.41. “Pružalac usluga isporuke internet sadržaja”- podrazumeva pružaoca usluge informacionog društva čija je glavna svrha ili jedna od glavnih svrha da čuva i obezbedi javni pristup velikoj količini autorskih dela ili drugih zaštićenih predmeta koje postavljaju njegovi korisnici, a koje organizuje i promovise radi profita. Pružaoци usluga, kao što su neprofitne onlajn enciklopedije, neprofitne obrazovne i naučne riznice, platforme za razvoj i distribuciju softvera otvorenog koda, provajderi usluga elektronskih komunikacija, onlajn tržišta, usluge u oblaku između preduzeća i usluge u oblaku koje korisnicima omogućavaju da otpremaju sadržaj za svoje lične korišćenje nisu „pružaoци usluga distribucije sadržaja na Internetu“ u smislu ovog zakona;</p>
---	--	--

<p>1.42. “Vepër origjinale e artit” - nënkupton çdo vepër të artit të bukur, të tilla si fotografi, kolazhe, pikturë, vizatime, gravura, printime, litografi dhe skulptura, vepra të tilla të arteve të aplikuara si arti i tekstilit, qeramika dhe qelqë dhe vepra fotografike, me kusht që të jenë të bëra nga vetë autori ose janë kopje që konsiderohen si vepra arti origjinale. Kopjet e veprave të artit do të konsiderohen si vepra origjinale nëse janë bërë në numër të kufizuar nga vetë autori ose nën autoritetin e tij. Kopjet e veprave të artit të cilat janë të numëruara, të nënshkruara ose ndryshe të autorizuar siç duhet nga autori, do të konsiderohen si kopje të tilla;</p> <p>1.43. “Entitet i pavarur menaxhues” - nënkupton çdo organizatë e cila është e autorizuar me ligj ose me përcaktim, licencë ose me ndonjë marrëveshje tjetër kontraktuale për të menaxhuar të drejtat e autorit ose të drejtat e përafërta në emër të më shumë se një titullari, për përfitim të kolektiv të atyre bartësve të të drejtave, si qëllimi i tij i vetëm ose kryesor, dhe që është:</p> <p>1.43.1. as në pronësi dhe as e kontrolluar, drejtpërdrejtë ose jo-drejtpërdrejtë, tërësisht ose</p>	<p>1.42. “Original work of art” means any work of fine art, such as pictures, collages, paintings, drawings, engravings, prints, lithographs, and sculptures, such works of applied arts as tapestries, ceramics and glassware and photographic works, provided they are made by the author himself or are copies considered to be original works of art. Copies of works of art shall be considered to be original works if they have been made in limited number by the author himself or under his authority. Copies of works of art which are numbered, signed or otherwise duly authorized by the author, shall be considered to be such copies;</p> <p>1.43. “Independent management entity” means any organisation which is authorised by law or by way of assignment, licence or any other contractual arrangement to manage copyright or rights related to copyright on behalf of more than one rightholder, for the collective benefit of those rightholders, as its sole or main purpose, and which is:</p> <p>1.43.1 neither owned nor controlled, directly or</p>	<p>1.42. “Originalno umetničko delo” - podrazumeva svako umetničko delo, kao što su fotografije, kolaži, slike, crteži, gravure, grafike, litografije i skulpture, dela primenjene umetnosti kao što su tapiserije, keramika i staklo i fotografska dela, pod uslovom da ih je izradio sam autor ili su kopije koje se smatraju originalnim umetničkim delima. Kopije umetničkih dela smatraće se originalnim delima ako ih u ograničenom broju izradi sam autor ili pod njegovim ovlašćenjem. Kopije umetničkih dela koji su numerisani, potpisani ili na drugi način ovlašćeni na odgovarajući način od strane autora, smatraju se kao takve kopije;</p> <p>1.43. “Nezavisni subjekat upravljanja” - podrazumeva svaku organizaciju koja je zakonom ili imenovanjem, licencom ili drugim ugovornim sporazumom ovlašćena da upravlja autorskim ili srodnim pravima u ime više od jednog nosioca, za kolektivnu korist tih nosilaca prava, kao svoju jedinu ili glavnu svrhu, a to je:</p> <p>1.43.1. ni u vlasništvu ni pod kontrolom, direktno ili</p>
---	--	--

<p>pjesërisht, nga bartësit e të drejtave;</p> <p>1.43.2. organizuar mbi baza fitimprurëse.</p> <p>1.44. “Bartës i së drejtës” - nënkupton çdo person ose subjekt që zotëron të drejtën e autorit ose të drejtën e përafërt, ose sipas një marrëveshjeje për shfrytëzimin e të drejtave ose sipas ligjit ka të drejtën për një pjesë të të ardhurave nga të drejtat;</p> <p>1.45. “Anëtar” - nënkupton një bartës të së drejtës ose një subjekt që përfaqëson mbajtësit e të drejtave, duke përfshirë organizatat e tjera të menaxhimit kolektiv dhe shoqatat e bartësve të të drejtave, që përmbushin kushtet e anëtarësimit të organizatës së menaxhimit kolektiv dhe të pranuar prej saj;</p> <p>1.46. “Statut”- nënkupton memorandum dhe dispozitat e asociimit, statutin, rregullat ose dokumentet e themelimit të një organizate të menaxhimit kolektiv;</p> <p>1.47. “Asambleja e përgjithshme e anëtarëve” - nënkupton organin në organizatën e menaxhimit kolektiv, në të</p>	<p>indirectly, wholly or in part, by rightholders;</p> <p>1.43.2 organised on a for-profit basis.</p> <p>1.44. “Rightholder” means any person or entity, other than a collective management organisation, that holds a copyright or related right or, under an agreement for the exploitation of rights or by law, is entitled to a share of the rights revenue;</p> <p>1.45. “Member” means a rightholder or an entity representing rightholders, including other collective management organisations and associations of rightholders, fulfilling the membership requirements of the collective management organisation and admitted by it;</p> <p>1.46. “Statute” means the memorandum and articles of association, the statute, the rules or documents of constitution of a collective management organisation;</p> <p>1.47. “General assembly of members” means the body in the collective management organisation</p>	<p>indirektno, u celini ili delimično, od strane nosilaca prava;</p> <p>1.43.2. organizovano na profitnoj osnovi.</p> <p>1.44. “Nosilac prava” - podrazumeva svako lice ili entitet koji poseduje autorsko ili srodno pravo, na osnovu ugovora o licenci ili po zakonu ima pravo na deo prihoda od prava;</p> <p>1.45. “Član” - podrazumeva nosioca prava ili entitet koji predstavlja nosioce prava, uključujući druge organizacije za kolektivno upravljanje i udruženja nosilaca prava, koji ispunjavaju uslove članstva u organizaciji za kolektivno upravljanje i koje je ona prihvatila;</p> <p>1.46. “Statut” - znači memorandum i odredbe udruženja, statut, pravila ili osnivačka dokumenta organizacije za kolektivno upravljanje;</p> <p>1.47. “Generalna skupština članova” - podrazumeva organ u organizaciji kolektivnog upravljanja, u kome</p>
--	---	--

<p>cilin anëtarët marrin pjesë dhe ushtrojnë të drejtën e votës, pavarësisht nga forma ligjore e organizatës;</p> <p>1.48. “Të ardhurat nga të drejtat” - nënkuptojnë të ardhurat e mbledhura nga një organizatë e menaxhimit kolektiv në emër të bartësve të të drejtave, qoftë ato që rrjedhin nga një e drejtë ekskluzive, e drejta për shpërblim ose nga e drejta për kompensim;</p> <p>1.49. “Tarifa e menaxhimit” - nënkupton shumat e ngarkuara, të zbritura ose të kompensuara nga një organizatë e menaxhimit kolektiv nga të ardhurat e të drejtave ose nga të hyrat që vijnë nga investimi i të ardhurave nga të drejtat, për të mbuluar kostot e menaxhimit të të drejtave të autorit ose të të drejtave të përafërta;</p> <p>1.50. “Marrëveshje përfaqësimi” nënkupton çdo marrëveshje ndërmjet organizatave të menaxhimit kolektiv, sipas së cilës një organizatë e menaxhimit kolektiv mandaton një organizatë tjetër të menaxhimit kolektiv për të menaxhuar të drejtat që ajo përfaqëson, duke përfshirë një marrëveshje të lidhur sipas neneve 114 dhe 115;</p>	<p>wherein members participate and exercise their voting rights, regardless of the legal form of the organisation;</p> <p>1.48. “Rights revenue” means income collected by a collective management organisation on behalf of rightholders, whether deriving from an exclusive right, a right to remuneration or a right to compensation;</p> <p>1.49. “Management fees” means the amounts charged, deducted or offset by a collective management organisation from rights revenue or from any income arising from the investment of rights revenue in order to cover the costs of its management of copyright or related rights;</p> <p>1.50. “Representation agreement” means any agreement between collective management organisations whereby one collective management organisation mandates another collective management organisation to manage the rights it represents, including an agreement concluded under Articles 114 and 115;</p>	<p>članovi učestvuju i ostvaruju pravo glasa, bez obzira na pravni oblik organizacije;</p> <p>1.48. “Prihodi od prava” - podrazumeva prihode koje prikuplja organizacija za kolektivno upravljanje u ime nosilaca prava, bilo da potiču iz ekskluzivnog prava, prava na naknadu ili prava na naknadu;</p> <p>1.49. “Naknada za upravljanje” - podrazumeva sume koje naplaćuje, odbija ili nadoknađuje organizacija za kolektivno upravljanje od prihoda od prava ili od prihoda koji proizilaze iz ulaganja prihoda od prava, za pokrivanje troškova upravljanja autorskim ili srodnim pravima;</p> <p>1.50. “Sporazum o zastupanju” - podrazumeva svaki sporazum između organizacija za kolektivno upravljanje prema kojem jedna organizacija za kolektivno upravljanje ovlašćuje drugu organizaciju za kolektivno upravljanje da upravlja pravima koje ona zastupa, uključujući sporazum sklopljen prema članovima 114 i 115;</p>
--	---	--

<p>1.51. “Përdorues” nënkupton çdo person ose subjekt që kryen veprime që i nënshtrohen autorizimit të bartësve të të drejtave, shpërblimit të bartësve të së drejtës ose pagesës së kompensimit për bartësit e të drejtave dhe nuk vepron në cilësinë e konsumatorit;</p> <p>1.52. “Repertor” nënkupton veprat në lidhje me të cilat një organizatë e menaxhimit kolektiv menaxhon të drejtat;</p> <p>1.53. “Licencë shumë-territoriale” - nënkupton një licencë që mbulon territorin e më shumë se një shteti;</p> <p>1.54. “Sasi të mjaftueshme” - nënkupton një sasi të tillë që plotëson kërkesat e arsyeshme të publikut për kopjet e regjistrimit zanor;</p> <p>1.55. “Personat me dëmtim të shikimit ose aftësi të kufizuara në lexim” nënkupton personat të cilët nuk janë në gjendje, si rezultat i një dëmtimi fizik ose mendor ose të një paaftësie perceptuese, të lexojnë vepra letrare, qoftë edhe me ndihmën e një mjeti pamor, në të njëjtën masë sa personat pa një dëmtim ose paaftësi të tillë;</p>	<p>1.51. “User” means any person or entity that is carrying out acts subject to the authorisation of rightholders, remuneration of rightholders or payment of compensation to rightholders and is not acting in the capacity of a consumer;</p> <p>1.52. “Repertoire” means the works in respect of which a collective management organisation manages rights;</p> <p>1.53. “Multi-territorial licence” means a licence which covers the territory of more than one State;</p> <p>1.54. “Sufficient quantities” means such quantity as to satisfy the reasonable requirements of the public for copies of the sound recording;</p> <p>1.55. “Persons with a visual impairment or reading disability” means persons who are unable, as a result of a physical or mental impairment or of a perceptual disability, to read literary works, even with the assistance of a visual aid, to substantially the same degree as persons without such an impairment or disability;</p>	<p>1.51. “Korisnik” - podrazumeva svako lice ili entitet koji obavlja dela koje su predmet ovlašćenja nosilaca prava, naknade nosilaca prava ili plaćanja naknade nosiocima prava i ne deluje u svojstvu potrošača;</p> <p>1.52. “Repertoar” podrazumeva dela u vezi sa kojima organizacija za kolektivno upravljanje upravlja pravima;</p> <p>1.53. “Multi-teritorijalna licenca” - podrazumeva licencu koja pokriva teritoriju više od jedne zemlje;</p> <p>1.54. “Dovoljna količina” – podrazumeva količinu koja zadovoljava razumne potrebe javnosti za kopijama zvučnog zapisa;</p> <p>1.55. “Osobe sa oštećenjem vida ili smetnje u čitanju” označavaju osobe koje nisu u stanju, zbog fizičkog ili mentalnog oštećenja ili poremećaja percepcije, da čitaju književna dela, čak i uz pomoć vizuelnog pomagala, u istoj meri kao osobe bez takvo oštećenje ili invaliditet;</p>
--	---	--

<p>1.56. Personi përfitues nënkupton, pavarësisht nga çdo paaftësi tjetër, një person që:</p> <p>1.56.1. është i verbër;</p> <p>1.56.2. ka një dëmtim të shikimit që nuk mund të përmirësohet në mënyrë që t'i japë personit funksionin vizual në thelb të barabartë me atë të një personi që nuk ka një dëmtim të tillë dhe i cili, si rezultat, nuk është në gjendje të lexojë vepra të shtypura në të njëjtën shkallë si një person pa një dëmtim të tillë;</p> <p>1.56.3. ka një paaftësi perceptuese ose lexuese dhe, si rezultat, nuk është në gjendje të lexojë vepra të shtypura në thelb të njëjtë si një person pa një paaftësi të tillë; ose</p> <p>1.56.4. përndryshe nuk është në gjendje, për shkak të një paaftësie fizike, të mbajë ose të manipulojë një libër ose të përqendrojë ose lëvizë sytë në masën që normalisht do të ishte e pranueshme për lexim.</p> <p>1.57. “Kopje e formatit të qasshëm” - nënkupton një kopje e një vepre ose një</p>	<p>1.56. A beneficiary means, notwithstanding any other disability, a person who:</p> <p>1.56.1 is blind;</p> <p>1.56.2 has a visual impairment which cannot be improved so as to give the person visual function substantially equivalent to that of a person who has no such impairment, and who is, as a result, unable to read printed works to substantially the same degree as a person without such an impairment;</p> <p>1.56.3 has a perceptual or reading disability and is, as a result, unable to read printed works to substantially the same degree as a person without such disability; or</p> <p>1.56.4 is otherwise unable, due to a physical disability, to hold or manipulate a book or to focus or move their eyes to the extent that would be normally acceptable for reading.</p> <p>1.57. “accessible format copy” means a copy of a work or other</p>	<p>1.56. ‘korisnik’ predstavlja, bez obzira na bilo koju drugu invalidnost, osobu koja:</p> <p>1.56.1. je slep;</p> <p>1.56.2. ima oštećenje vida koje se ne može poboljšati tako da se osobi pruži vizuelna funkcija suštinski ekvivalentna onoj osobe koja nema takvo oštećenje, i koja kao rezultat toga nije u stanju da čita štampana dela u suštinski istom stepenu kao osoba bez takvog oštećenja;</p> <p>1.56.3. ima smetnje u percepciji ili čitanju i, kao rezultat, nije u stanju da čita štampana dela u suštinskom istom stepenu kao osoba bez takve smetnje; ili</p> <p>1.56.4. inače nije u stanju, zbog fizičkog invaliditeta, da drži ili rukuje knjigom ili da fokusira ili pomera oči do mere koja bi inače bila prihvatljiva za čitanje.</p> <p>1.57. “Kopija u dostupnom formatu” - podrazumeva kopiju zaštićenog dela</p>
--	---	---

<p>lënde tjetër të mbrojtur, që në një mënyrë ose formë alternative i jep një personi përfitues qasje në veprën ose lëndën tjetër, duke përfshirë lejimin e një personi të tillë që të ketë qasje në mënyrë të mundshme dhe të rehatshme si një person me shikim të dëmtuar ose me paaftësi për lexim;</p> <p>1.58. “Subjekt i autorizuar” - nënkupton një subjekt që është i autorizuar ose i njohur nga Republika e Kosovës për të ofruar arsim, trajnim mësimor, lexim të adaptuar ose qasje në informacion për personat me shikim të dëmtuar të ose aftësi të kufizuara në lexim në baza jofitimprurëse. Gjithashtu përfshinë një institucion publik ose organizatë jofitimprurëse që ofron të njëjtat shërbime për personat përfitues si një nga aktivitetet e tij kryesore, detyrimet institucionale ose si pjesë e misionëve të tij me interes publik;</p> <p>1.59. “Masat teknologjike” - do të thotë çdo teknologji, pajisje ose element që është projektuar për të parandaluar ose kufizuar veprimet në rrjedhën normale të funksionimit të saj, në lidhje me veprat ose objektet e të drejtave të përafërta, të cilat nuk janë të autorizuar nga pronari i të drejtave;</p>	<p>subject matter in an alternative manner or form that gives a beneficiary person access to the work or other subject matter, including allowing such person to have access as feasibly and comfortably as a person without any of the impairments or disabilities;</p> <p>1.58. “Authorised entity” means an entity that is authorised or recognised by Kosovo Republic to provide education, instructional training, adaptive reading or information access to persons with a visual impairment or reading disability on a non-profit basis. It also includes a public institution or non-profit organisation that provides the same services to beneficiary persons as one of its primary activities, institutional obligations or as part of its public-interest missions;</p> <p>1.59. “Technological measures” means any technology, device or component that is designed to prevent or restrict acts in the normal course of its operation in respect of works or objects of related right, which are not authorized by the owner of rights;</p>	<p>ili drugog predmeta koji na alternativni način ili oblik daje korisniku pristup delu ili drugom predmetu, uključujući omogućavanje takvoj osobi da potencijalno pristupi i da se oseća udobno kao osoba sa oštećenim vidom ili disleksijom;</p> <p>1.58. “Ovlašćeni subjekat” - podrazumeva subjekat koji je ovlašćen ili priznat od strane Republike Kosovo da pruža obrazovanje, nastavnu obuku, prilagođeno čitanje ili pristup informacijama za osobe sa oštećenjem vida ili s invaliditetom na neprofitnoj osnovi. Takođe uključuje javnu ustanovu ili neprofitnu organizaciju koja pruža iste usluge korisnicima kao jednu od svojih glavnih aktivnosti, institucionalnih obaveza ili kao deo svojih misija od javnog interesa;</p> <p>1.59. “Tehnološke mere” - znači bilo koju tehnologiju, uređaj ili element koji je dizajniran da spreči ili ograniči dela u normalnom toku svog rada, u vezi sa delima ili objektima srodnih prava, koji nisu ovlašćeni od strane vlasnika prava;</p>
--	--	--

<p>1.60. “Informacion për menaxhimin e të drejtave” nënkupton çdo informacion të dhënë nga autori ose pronari tjetër i së drejtës, që identifikon veprën ose objektet e të drejtave të përafërta, autorin ose pronarin tjetër të së drejtës, ose informacionin mbi kushtet e përdorimit të veprës ose objektit të mbrojtur, si dhe numrat dhe kodet që përfaqësojnë një informacion të tillë.</p> <p style="text-align: center;">Neni 4 Marrëdhënia midis të drejtës së autorit dhe të drejtave të përafërta</p> <p>1. Mbrojtja e përcaktuar me këtë ligj për të drejtat e përafërta nuk prek dhe nuk ndikon në asnjë mënyrë në mbrojtjen e të drejtës së autorit.</p> <p>2. Mbrojtja e të drejtës së autorit dhe kategorive të ndryshme të të drejtave të përafërta, është gjithashtu e pavarur nga njëra-tjetra në kuptimin që, kur i njëjti person fizik ose juridik është pronar i më shumë se një lloji të drejtash të autorit dhe e çdo të drejte të përafërt, i njëjti përveç nëse parashikohet ndryshe në këtë ligj, do t'i gëzojë dhe mund t'i ushtrojë ato të drejta veçmas dhe pavarur nga njëra-tjetra.</p>	<p>1.60. “Rights management information” means any information, provided by the author or other owner of right, identifying the work or an object related rights, the author or other owner of right, or information on the conditions of the use of the work or object of protection, as well as any numbers and codes representing such information.</p> <p style="text-align: center;">Article 4 The relation between copyright and related rights</p> <p>1. Protection defined by this Law for related rights shall leave intact and shall in no way affect the protection of copyright.</p> <p>2. Protection of copyright and the various categories of related rights shall also be independent from each other in the sense that, where the same physical person or legal entity is the owner of more than one kind of rights – copyright and any related right – he or it, unless otherwise provided in this Law shall enjoy and may exercise those rights separately and independently from each other.</p>	<p>1.60.“Informacije o upravljanju pravima” podrazumeva svaku informaciju koju je dao autor ili drugi nosilac prava koja identifikuje delo ili objekte srodnih prava, autora ili drugog nosioca prava, ili informacije o uslovima korišćenja zaštićenog dela ili objekta, kao i brojeve i šifre koje predstavljaju takve informacije.</p> <p style="text-align: center;">Član 4 Odnos između autorskog i srodnih prava</p> <p>1. Zaštita utvrđena ovim zakonom za srodna prava ne utiče i ni na koji način ne utiče na zaštitu autorskih prava.</p> <p>2. Zaštita autorskog prava i različitih kategorija srodnih prava je takođe nezavisna jedna od druge u smislu da, kada je isto fizičko ili pravno lice vlasnik više od jedne vrste autorskog prava i svakog srodnog prava, isti, osim ako nije drugačije određeno u ovom zakonu, uživaju i mogu ostvarivati ta prava odvojeno i nezavisno jedno od drugog.</p>
--	---	---

<p>3. Dispozitat e këtij ligji zbatohen ngjashëm ose “mutatis mutandis” edhe ndaj të drejtave të përafërta, në lidhje me:</p> <p>3.1. elementet e të drejtës së autorit;</p> <p>3.2. bashkautorësinë dhe autorësinë e veprave kolektive dhe të gërshetuara;</p> <p>3.3. prezumimin e autorësisë;</p> <p>3.4. veprat e krijuara në marrëdhënien e punës;</p> <p>3.5. të drejtën e patjetërsueshme për një shpërblim të drejtë pasi të kenë transferuar të drejtat e tyre të qirasë në një prodhues;</p> <p>3.6. caktimin dhe licensimin e drejtës ekonomike;</p> <p>3.7. shpërblimin e autorit, dhe të drejtën e rishikimit të një shpërblimi jo proporcional, detyrimin për transparencë dhe zgjidhjen e njëanshme të kontratës për të drejtën e autorit;</p> <p>3.8. kompensimin e drejtë në lidhje me riprodhimet në letër ose në çdo medium të ngjashëm, i kryer nga përdorimi i çdo lloj teknikë fotografike ose nga ndonjë proces tjetër që ka efekte të ngjashme, me përjashtim të partiturave muzikore dhe në</p>	<p>3. Shall The provisions of this Law regarding:</p> <p>3.1. the elements of the author’s work;</p> <p>3.2 the joint authorship and authorship on collective and composite works;</p> <p>3.3. the presumptions of authorship;</p> <p>3.4. works created under employment;</p> <p>3.5. the unwaivable right to equitable remuneration after having transferred their rental rights to a producer;</p> <p>3.6 Assignment and licensing of economic right;</p> <p>3.7. the author’s remuneration, the right of revision of a disproportionate remuneration, the transparency obligation and the unilateral termination of a copyright contract;</p> <p>3.8. fair compensation in respect of reproductions on paper or any similar medium, effected by the use of any kind of photographic technique or by some other process having similar effects, with the exception of sheet</p>	<p>3. Odredbe ovog zakona se shodno ili “mutatis mutandis” primenjuju na srodna prava, u odnosu na:</p> <p>3.1. elementi autorskog prava;</p> <p>3.2. koautorstvo i autorstvo kolektivnih i povezanih dela;</p> <p>3.3. pretpostavka autorstva;</p> <p>3.4. dela kreirana u radnom odnosu;</p> <p>3.5. neotuđivo pravo na pravičnu nadoknadu nakon što su svoja prava zakupa preneli na proizvođača;</p> <p>3.6 prenos i licenciranje ekonomskog prava;</p> <p>3.7. autorska naknada i pravo na preispitivanje neproporcionalne naknade, obaveza transparentnosti i jednostrani raskid autorskog ugovora;</p> <p>3.8. pravičnu naknadu u pogledu reprodukcija na papiru ili na bilo kom sličnom mediju napravljenim upotrebom bilo koje vrste fotografske tehnike ili bilo kojim drugim procesom koji ima slične efekte, izuzev muzičkih</p>
--	--	--

<p>lidhje me riprodhimet në çdo medium të bëra nga një person fizik për përdorim privat dhe për qëllime që nuk janë drejtpërdrejtë as tërthortë komerciale;</p> <p>3.9. marrëdhënien ndërmjet të drejtës së autorit dhe pronësisë në objektin fizik në të cilën është e shprehur vepra, qoftë në formën origjinale ose në çdo formë kopjimi;</p> <p>3.10. kufizimet e të drejtës së autorit;</p> <p>3.11. llogaritjen e fillimit të mbrojtjes dhe efektin e përfundimit të kohëzgjatjes së mbrojtjes të së drejtës së autorit, si dhe kalimin e të drejtës së autorit;</p> <p>3.12. shuarjen e të drejtës së shpërndarjes me shitjen e parë ose një lloj tjetër kalimit të pronësisë të një vepre origjinale ose kopje të saj, të bërë nga autori ose me autorizimin i tij.</p>	<p>music and in respect of reproductions on any medium made by a natural person for private use and for ends that are neither directly nor indirectly commercial, on condition;</p> <p>3.9. the relation between the copyright and the transfer of the ownership of the physical carrier into which the work has been incorporated, whether in the original form or in any form of copy;</p> <p>3.10. the limitations of copyright;</p> <p>3.11. the calculation of the starting of protection term and the effect of conclusion of protection term of the copyright, as well as the assignments of author's right;</p> <p>3.12. the exhaustion of distribution right by first sale or other type of transfer of ownership in an original or a copy of work made by the author or his authorization.</p>	<p>partitura i u pogledu reprodukcija u bilo kom mediju od strane fizičko lice za privatnu upotrebu i za svrhe koje nisu neposredno ili posredno komercijalne;</p> <p>3.9. odnos između autorskog prava i vlasništva nad fizičkim objektom u kome je delo izraženo, bilo u originalnom obliku ili u bilo kom obliku kopiranja;</p> <p>3.10. ograničenja autorskih prava;</p> <p>3.11. uračunavanje početka zaštite i dejstvo prestanka trajanja autorske zaštite, kao i prenosa autorskog prava;</p> <p>3.12. gašenje prava distribucije prvom prodajom ili drugim vidom prenosa svojine na originalno delo ili njegovu kopiju, koji je izvršio autor ili po njegovom ovlašćenju.</p>
---	--	---

<p style="text-align: center;">KAPITULLI II</p> <p style="text-align: center;">E DREJTA E AUTORIT</p> <p style="text-align: center;">NËNKAPITULLI I</p> <p>Lënda e mbrojtur me të drejtën e autorit</p> <p style="text-align: center;">Neni 5 Veprat e Mbrojtura</p> <p>1. “Vepër” nënkupton çdo krijim në fushën e letërsisë, artit ose shkencës që është origjinal, në kuptimin që është krijim intelektual i vetë autorit. Asnjë kriter tjetër nuk do të aplikohet që një krijim i tillë të cilësohet si vepër.</p> <p>2. Mbrojtja me të drejtën e autorit do të shtrihet në çdo vepër, pavarësisht nga mënyra ose forma e shprehjes së saj, objektivi, rëndësia ose vlera estetike, në të tilla si:</p> <p style="padding-left: 20px;">2.1. vepra letrare (të shprehura me shkrim ose me gojë, duke përfshirë programet kompjuterike);</p> <p style="padding-left: 20px;">2.2. veprat dramatike dhe dramatiko-muzikore;</p>	<p style="text-align: center;">CHAPTER II</p> <p style="text-align: center;">COPYRIGHT</p> <p style="text-align: center;">SUBCHAPTER I</p> <p>Subject matter of copyright protection</p> <p style="text-align: center;">Article 5 Protected Works</p> <p>1. “Works” shall mean any production in the field of literature, art or science that is original in the sense that it is the author’s own intellectual creation; no other criteria shall be applicable for such a production to be qualified as a work.</p> <p>2. Protection by copyright shall extend to any works, whatever may be the mode or form of their expression, objective, importance or aesthetic value, in particular such as:</p> <p style="padding-left: 20px;">2.1. literary works (expressed in writing or orally, including computer programs);</p> <p style="padding-left: 20px;">2.2. dramatic and dramatico-musical works;</p>	<p style="text-align: center;">POGLAVLJE II</p> <p style="text-align: center;">AUTORSKO PRAVO</p> <p style="text-align: center;">POTPOGLAVLJE I</p> <p>Materijal zaštićen autorskim pravom</p> <p style="text-align: center;">Član 5 Zaštićena dela</p> <p>1. “Delo” podrazumeva svako stvaralaštvo iz oblasti književnosti, umetnosti ili nauke koje je originalno, u smislu da je autorovo sopstveno intelektualno stvaralaštvo. Neće se primenjivati nikakvi drugi kriterijumi da bi se takva stvaralaštvo kvalifikovalo kao delo.</p> <p>2. Zaštita autorskog prava obuhvata svako delo, bez obzira na njegov način ili oblik izražavanja, namenu, značaj ili estetsku vrednost, kao što su:</p> <p style="padding-left: 20px;">2.1. književna dela (pisana ili usmena, uključujući kompjuterske programe);</p> <p style="padding-left: 20px;">2.2. dramska i dramsko-muzička dela;</p>
---	--	---

<p>2.3. vepra muzikore, me ose pa fjalë;</p> <p>2.4. vepra koreografike dhe pantomimat;</p> <p>2.5. veprat kinematografike dhe veprat e tjera audiovizuale (në tekstin e mëtejme së bashku: “vepra audiovizuale”);</p> <p>2.6 veprat e arteve të bukura (piktura, vizatime, skulptura, etj.);</p> <p>2.7. veprat e arkitekturës;</p> <p>2.8. veprat fotografike, duke përfshirë veprat e shprehura nga çdo proces i ngjashëm me fotografinë;</p> <p>2.9. veprat e artit të aplikuar;</p> <p>2.10. harta, plane, skica dhe punime tredimensionale që kanë të bëjnë me gjeografinë, topografinë, arkitekturën dhe shkenca të tjera.</p> <p>3. Çdo pjesë ose element tjetër i veprës (përfshirë titullin ose personazhin e shprehur në të) që në vetvete paraqet krijim intelektual do të mbrohet si i tillë me të drejtën e autorit. Përdorimi i titullit të veprës nuk lejohet nëse ai titull është përdorur më parë për të njëjtin lloj vepre, nëse ky titull</p>	<p>2.3. musical works, with or without words;</p> <p>2.4. choreographic works and entertainment in dumb show;</p> <p>2.5. cinematographic works and other audiovisual works (hereinafter together: “audiovisual works”);</p> <p>2.6. works of fine arts (paintings, drawings, sculptures, etc.);</p> <p>2.7. works of architecture;</p> <p>2.8. photographic works, including works expressed by any process analogous to photography;</p> <p>2.9. works of applied art;</p> <p>2.10. maps, plans, sketches and three-dimensional works relating to geography, topography, architecture and other science.</p> <p>3. Any part or other element of a work (including its title, or a character expressed in it) that in itself represents intellectual creation shall also be protected as such by copyright. The use of work title shall not be allowed if that title has been used before for the same type of</p>	<p>2.3. muzička dela, sa ili bez reči;</p> <p>2.4. koreografska dela i pantomime;</p> <p>2.5. kinematografska dela i druga audiovizuelna dela (u daljem tekstu zajedno: „audiovizuelna dela“);</p> <p>2.6. dela likovne umetnosti (slike, crteži, skulpture, itd.);</p> <p>2.7. dela arhitekture;</p> <p>2.8. fotografska dela, uključujući dela izražene bilo kojim procesom sličnim fotografiji;</p> <p>2.9. dela primenjene umetnosti;</p> <p>2.10. karte, planovi, skice i trodimenzionalna dela koja se odnose na geografiju, topografiju, arhitekturu i druge nauke.</p> <p>3. Svaki deo ili drugi element dela (uključujući naslov ili lik izražen u njemu) koji sam po sebi predstavlja intelektualnu tvorevinu biće zaštićen kao takav autorskim pravom. Upotreba naslova dela nije dozvoljena ako je taj naslov ranije korišćen za istu vrstu dela, ako ovaj naslov stvara zabunu o autorstvu dela.</p>
---	---	---

<p>krijon konfuzion në lidhje me autorësinë e veprës.</p> <p>4. Pa cenuar mbrojtjen e të drejtës së autorit në veprat origjinale, me të drejtën e autorit si vepra mbrohen edhe ato vepra dhe koleksione të prejardhura që bazohen në një ose më shumë vepra para ekzistuese dhe/ose ndonjë material tjetër; veçanërisht:</p> <p>4.1. përkthimet, përshtatjet, shënimet, aranzhimet muzikore dhe transformime të tjera të ngjashme të veprave ose shprehjeve të folklorit, me kusht që ato të jenë rezultat i krijimit intelektual (vepra të prejardhura);</p> <p>4.2. koleksionet e veprave, të tilla si enciklopeditë dhe antologjitë, si dhe përmbledhjet e materialeve ose të dhënave të tjera, pavarësisht nëse janë të mbrojtura apo jo, duke përfshirë bazat e të dhënave, me kusht që ato, për shkak të përzgjedhjes ose aranzhimit të përmbajtjes së tyre, janë rezultat i krijimit intelektual.</p> <p>5. Mbrojtja e të drejtës së autorit të bazave të të dhënave nuk zbatohet për përmbajtjen e bazave të të dhënave dhe nuk cenon të drejtat që ekzistojnë në vetë ato përmbajtje.</p>	<p>work, if such title creates confusions regarding the authorship of work.</p> <p>4. Without prejudice to the protection of copyright in the original works, those derivative works and collections that are based on one or more pre-existing works and/or any other materials, shall also be protected by copyright as works; in particular:</p> <p>4.1 translations, adaptations, annotations, musical arrangements and other similar transformations of works or expressions of folklore, provided that they are the results of intellectual creation (derivative works);</p> <p>4.2 collections of works, such as encyclopedias and anthologies, as well as compilations of other materials or data irrespective of whether or not they are protected, including databases, provided that they, by reason of selection or arrangement of their contents, are the results of intellectual creation.</p> <p>5. The copyright protection of databases shall not extend to the contents of databases and shall be without prejudice</p>	<p>4. Ne ugrožavajući zaštitu autorskih prava na originalna dela, dela zaštićena autorskim pravima takođe štite izvedena dela i kolekcije koje su zasnovane na jednom ili više postojećih dela i/ili bilo kom drugom materijalu; posebno:</p> <p>4.1. prevodi, prilagođavanja, beleške, muzičke obrade i druge slične transformacije folklornih dela ili izraza, pod uslovom da su rezultat intelektualnog stvaralaštva (izvedena dela);</p> <p>4.2. zbirke dela, kao što su enciklopedije i antologije, i kompendijumi drugih materijala ili podataka, zaštićeni ili ne, uključujući baze podataka, pod uslovom da su, zbog izbora ili uređenja sadržaja, rezultat intelektualnog stvaralaštva.</p> <p>5. Autorska zaštita baza podataka ne odnosi se na sadržaj baza podataka i ne utiče na prava koja postoje u samim sadržajima.</p>
---	---	--

